



Më  
Dana

25 - 06 - 2010

P. nr. 247/08.

*GJF*

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA KOMUNALE NË FERIZAJ**, si gjykatë e shkallës së parë penale, e përbërë nga gjyqtari, Bashkim Hyseni, me procesmbajtësen, Hajrije Arifi, sekretare juridike në këtë gjykatë, në çështjen penale kundër të pandehurit [REDACTED] nga fsh. [REDACTED] – komuna e Shtimes, për veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nen. 297 par. 3 lidhur me par. 1 të KPK-së, sipas propozim akuzës së PPK-së në Ferizaj: Pp nr.151/08 të dt 31.03.2008. Pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më 26 maj 2010, në praninë e përfaqësuesit të akuzës - prokurorit publik, Rasim Malokut, të pandehurit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht komunikoi këtë:

### A K T G J Y K I M

**I pandehuri :** [REDACTED], djali i [REDACTED] dhe nënës [REDACTED] mbiemri i vajzërisë së nënës [REDACTED] i lindur me datë [REDACTED] në fsh. [REDACTED] – komuna e Shtimes, ku jeton edha tani, i martuar-prind i 3/tre/fëmijëve, i papune, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së varfér ekonomike.

### ËSHTË FAJTOR

Me dt. 24.01.08 rreth orës 18:00 në rrugën e ambulancës në Lypjan- afër ambulancës, duke drejtuar automjetin e tij të tipit "Golf" me targa të regjistrimit [REDACTED] duke lëvizur mbrapa prej parkingut e duke vepruar në kundërshtim me dispozitën e nenit 43 LTHSKRR-së, ka vënë në rrezik jetën e njerëzve, nga pakujdesia duke lëvizur mbrapa pa u siguruar mirë se rrugën në të cilën do të lëviz është e lirë dhe nuk do të rrezikon këmbësorët dhe pjesëmarrësit e tjerë, ashtu që me pjesën e djathtë të veturës së tij ka goditur këmbsorin [REDACTED] i cili ishte duke lëvizur nëpër trotuar me ç'rast i ka shkaktuar lëndime të lehta trupor dhe atë plagë shtypëse e gjurit të djathtë, dëmtim i lidhëses së kapakut së gjurit të këmbës së djathtë.-

- me të cilën ka kryer veprën penale rrezikim i trafikut publik nga nen. 297. par. 3 lidhur me par.1 të KPK-së..

Në bazë të dispozitës së sipërcituar si dhe dispozitat nga nen 3, 5, 6, 11, 16, 34, 41, 42, 43, 44 dhe 64, të KPK-së si dhe nenit 391 të KPPK-së i :

**SHQIPTON**

**DËNIM ME KUSHT**

Vërtetohet dënim burgimi në kohëzgjatje prej 4/katër/ muaj, i cili nuk do të ekzekutohet në periudhën kohore prej 1/ një viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale.

Të dëmtuarin [REDACTED] nga fshati [REDACTED] - komuna e Lipjanit, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontest civil..

Obligohet i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumen 55,55 €/ pesëdhjetë e pesë euro/ sii dhe paushallin gjyqësor në shumë prej 25 €/ njëzetë e pesë euro/ në afat prej 15/ pesëmbëdhjetë ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënimin e përmbarimit.

#### A r s y e t i m i

Pas shpalljes së aktgjykimit palët konformë nenit 394 par. 1 të KPPK-së janë udhëzuar mbi të drejtën e ankesës dhe detyrimin për ta paralajmëruar ankesën, pas kësaj prokurori publik, i pandehuri kanë deklaruar se heqin dorë nga e drejta e ankesës, ndërsa i dëmtuari [REDACTED] me parashtresën e dorëzuar me datë 26.05.2010 ka deklaruar se heqë dore nga e drejta e ankesës.

Me që palët kanë hequr dorë nga e drejta e ankesës konformë nenit 400 par.3 të KPPK-së aktgjykimi në rastet e tillë nuk ka nevojë të përbajë arsyetim.

Sek juridike,  
Hajrije Arifi

Gjyqtari,  
Bashkim Hyseni,